

KËRKESË PËR PAJISJEN ME AKTIN E MARRJES NË PRONËSI TË TOKËS BUJQËSORE TË ISH NDËRMARRJEVE BUJQËSORE

<u>Emri i Shërbimit</u>	Kërkesë për pajisjen me aktin e marrjes në pronësi të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore
<u>Përshkrim i Shkurtër</u>	Subjekte të përfitimit të tokës bujqësore në pronësi dhe të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore janë personat fizike dhe juridike vendas. Ky akt jepet për përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-kooperativës, të cilët nuk janë pajisur me aktin e marrjes së tokës në pronësi
<u>Baza ligjore:</u>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ▪ Ligji nr.9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” ▪ Ligji nr. 172/2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9948, datë 07.07.2008” Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” ▪ VKM nr.253, datë 06.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatra të ish kooperativave bujqësore”, të ndryshuar.
<u>Përfituesi</u>	Qytetarët
<u>Zyra Përgjegjëse</u>	Zyra/Specialisti i Drejtorisë Juridike
<u>Afati</u>	?
<u>Tarifa</u>	Nuk ka tarifë
<u>Dokumente të nevojshëm</u>	<p><u><i>Për përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me AMTP, duhet të paraqesin dokumentet si më poshtë:</i></u></p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kërkesën për pajisjen me AMTP për tokën që kanë marrë në përdorim nga komisionet e ndarjes së tokës; ▪ Plan vendosjen e secilës ngastër që kanë në përdorim, të përgatitur nga një subjekt i licencuar, sipas kërkesave të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku të pasqyrohen sipërfaqja, kufijtë e saj dhe kufitarët; ▪ Certifikatën familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile e njësisë së qeverisjes vendore, ku të pasqyrohen numri i anëtarëve të familjes përfituese ose individit, në favor të të cilit do të lëshohet akti i marrjes së tokës në pronësi, sipas gjendjes më 1 gusht 1991, me ndryshimet deri më 1 tetor 1992, të cilët nuk kanë ndryshuar vendbanimin e tyre që prej kësaj date; ▪ Dokumentacionin që vërteton se janë përfitues, si rezultat i lëvizjes nga qendrat e tyre të banimit, me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave; ▪ Aktin e marrjes së tokës bujqësore në përdorim, nëse e disponojnë. <p><u><i>Subjektet e përcaktuara si bashkë-themelues të ish-ndërmarrjes bujqësore, sipas VKM nr.452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore” të ndryshuar, të cilët nuk janë pajisur me AMTP, për tokën bujqësore që kanë në përdorim faktik duhet të paraqesin në dokumentacionin e mëposhtëm:</i></u></p>

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kërkesën për pajisjen me AMTP, për tokën që kanë marrë në përdorim nga komisionet e ndarjes së tokës; ▪ Dokumentacionin kadastral, hipotekor, arkivor apo gjyqësor që provon pronësinë mbi tokën bujqësore apo rrënjët e ullinjve para reformës agrare dhe qenien e tyre si themelues të ish-kooperativës apo ish-ndërmarrjes bujqësore; ▪ Plan vendosjen e ngastrës/ave që subjekti përdor për qëllime bujqësore, të përgatitura nga një subjekt i licencuar, sipas kërkesave të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku të pasqyrohen sipërfaqja, kufijtë e saj dhe kufitarët; ▪ Certifikatën e trungut familjar (përbërjen e familjes) në momentin e dorëzimit të tokës bujqësore dhe çdo dokument tjetër, në përputhje me përcaktimet e VKM nr.452, datë 17.10.1992, i ndryshuar; ▪ Aktin e marrjes së tokës bujqësore në përdorim, nëse e disponojnë.
<u>Dokumenti/at e prodhuar si rezultat i shërbimit (outputs)</u>	Akti i marrjes së tokës bujqësore
<u>Sporteli ku drejtohet qytetari për marrjen e shërbimit</u>	Sporteli në Bashki Sporteli në Njësinë Administrative